



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 26.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Compass IT SHPK" për aktivitetin: "**Organizimi i panairit "Blej Shqip"**", me numër të prokurimit: **616-19-8647-121** nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Compass IT SHPK" e datës 23.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Organizimi i panairit "Blej Shqip"**" me numer të prokurimit **616-19-8647-236** kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së, të datës 21.11.2019 të publikuar në E-Prokurim;
2. **Pezullohet Vendimi i AK i publikuar me datë: 21.11.2019;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin ta kthejë në rivleresim.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Compass IT" me datë 23.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Organizimi i panairit "Blej Shqip"**" me numër 616 19 8647 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.11.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Deklarata nën betim nuk është nënshkruar nga personi i autorizuar nuk është e bazuar pasi që tenderi dorezohet në formë elektronike dhe në bazë të dokumentacioni verifikohet lehtë personi përgjegjës;

-Pretendimi për mungesën e nënshkrimit në Aneskin 6 poashtu nuk është i bazuar pasi që oferta është dorezuar në formë elektronike; dhe

-Pretendimet per modifikim te pershkrimit te çmimeve jane te bazuara pasi qe ky modifikim eshte i pa lejuar dhe tenderuesi duhet te plotesoj çdo dokument duke perfshire edhe pershkrimin e çmimit ne formen e kerkuar ne dosjen e tenderit.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit